

# NDIHMA SHETËRORE NË KOSOVË: Koha për t'u Zgjuar!

—  
Korrik 2019





GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

---

# Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Është një organizatë e pavarur, jopartiake dhe jo-fitimprurëse e politikave publike me qendër në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të zhvillojmë hulumtime të besueshme në fushën e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjme përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ ose trajtojnë problemet në fushat e politikave të lartpërmendura.

Analizë Politikash 07/2019

## NDIHMA SHTETËRORE NË KOSOVË: Koha për t'u Zgjuar!

Autore: Erëza Pula

Korrik 2019

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Korrik, 2019.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e stafit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, donatorëve e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike  
Rr. "Rexhep Luci", 16/1  
Prishtinë 10 000, Kosovë  
Ueb : [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)  
E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)  
Tel/fax.: +381 38 234 456

*"Ky botim është realizuar me përkrahjen e Agjencionit Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Sida-së, dhe KCSF-së."*

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

# NDIHMA SHETËRORE NË KOSOVË: KOHA PËR T'U ZGJUAR!

## I. Hyrje

Në kuadër të politikave të konkurrencës, në vendet anëtare të Bashkimit Evropian një vëmendje e veçantë i është dhënë kontrollit të Ndhmës Shtetërore, sidomos gjatë dekadës së fundit. Ndhma Shtetërore dallon nga 'lloji tipik i ligjit konkurrencës' i cili trajton bashkimet e ndërmarrësive, dominimin në treg dhe zbatimin e karteleve. Objektiva kryesore e kontrollit të Ndhmës Shtetërore është të siguroj ruajtjen e konkurrencës në treg dhe tregtinë.<sup>1</sup> Saktësisht, Ndhma Shtetërore është asistencë që Qeveria u siguron përfituesve – “çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, i cili kryen një aktivitet ekonomik, dhe në këtë mënyrë merr pjesë në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve” – e shoqëruar me një shtrembërim të drejtpërdrejtë apo të mundshëm të konkurrencës duke favorizuar përfitues të caktuar.<sup>2</sup>

Dispozitat adekuate ligjore të kontrollit të Ndhmës Shtetërore mbrojnë funksionimin e tregut të brendshëm dhe konkurrencën, duke siguruar që ndërmarrësitë e caktuara të mos fitojnë avantazh konkurrues përmes ndihmës shtetërore. Në përgjithësi, ndhma shtetërore që jepet nga institucionet apo ofruesit e ndihmës shtetërore është e ndaluar nëse supozohet e padrejtë, si dhe nëse promovon konkurrencën e njëanshme duke reduktuar kostot marginale për përfituesit e ndihmës shtetërore, ndërkohë duke imponuar barrën financiare taksa-paguesve. Në këtë linjë mendimi, arsytimi kryesorë për domethënien e kontrollit të Ndhmës Shtetërore i dhënë nga studiuesit ka një qëllim të dyfishtë, mikroekonomik dhe makroekonomik, bazuar në faktin që mundohet të ekuilibrojë tregtinë ndërmjet konkurrencës së tregut si dhe interesin shoqëror dhe publik.<sup>3</sup>

Forca shtytëse që ka dërguar në futjen e dispozitave vendore për Ndhmë Shtetërore, përveç ruajtjes së konkurrencës, i atribuohet pjesërisht edhe perspektivës së Integritimit Evropian të vendeve të Evropës Jug Lindore (VEJL).<sup>4</sup> Kosova së bashku me vende tjera të VEJL ka kohë që i kanë shprehur aspiratat e tyre drejt Integritimit Evropian. Si pjesë e procesit, Kosova – e fundit në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimorë – ka nënshkruar

---

<sup>1</sup> Departamenti për Inovacion dhe aftësim të Biznesit (2015), “Ndhma Shtetërore: Udhëzimet Bazë”, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, Londër, në dispozicion në: [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/443686/BIS-15-417-state-aid-the-basics-guide.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/443686/BIS-15-417-state-aid-the-basics-guide.pdf)

<sup>2</sup> Ligji për Ndhmën Shtetërore. 05/L-100, në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/AB373100-5DE7-45A4-BE96-CD1EF11E79AE.pdf>

<sup>3</sup> Yo Sop Choi (2010), “Politikë e BE-së për Konkurrencën përmes Ndhmës Shtetërore”, Rishikim I Hapësirës Ndërkombëtare, Instituti për Studime Ligjore, “Hankuk University of Foreign Studies”, në dispozicion në: <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/223386591001300215>

<sup>4</sup> Marco Botta (2012), “Kontrolli i Ndhmës Shtetërore në Evropën Jug-Lindore: Tranzicioni i pafund”, Dokument Pune nga Konferenca e UACES 2012, University of Passau Panel – Zgjerimi i BE-së IV, Institute për Kërkime të Integritimit Evropian (EIF), Universiteti i Vienws, në dispozicion në : <https://www.uaces.org/documents/papers/1201/botta.pdf>

Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) në Nëntor 2015, e cila ka hyrë në fuqi në Prill 2016.<sup>5</sup> Duke pasur parasysh se shumica e Marrëveshjes është e bazuar në Acquis, Kosova sigurisht që ka ndërmarrë një rrugëtim të vështirë për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me acquis-në.<sup>6</sup> Duke thënë këtë, Komisioni Evropian e thekson rëndësinë e përputhshmërisë së ligjit kombëtar me acquis-në e BE-së, duke përfshirë këtu edhe dispozitat për kontrollin e Ndhmës Shtetërore.<sup>7</sup> Në përgjithësi, vendet e VEJL kanë miratuar dhe përafuar dispozitat legjislative kombëtare për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore me Acquis-në e BE-së. Sidoqoftë, është ende e nevojshme që të ketë një përafrim të mëtjshëm të legjislacionit dytësor në mënyrë që legjislacioni ekzistues të përafrohet më shumë me acquis-në e BE-së, siç është poashtu edhe rasti i Kosovës.<sup>8</sup>

Ky studim analizon kornizën ligjore që rregullon fushën e ndihmës shtetërore duke u fokusuar në kornizën ligjore vendore dhe atë të BE-së; ofron një renditje kronologjike të ngjarjeve në lidhje me funksionalizimin e Departamentit për Ndhmë Shtetërore dhe Komisionit të tij; thekson prioritetet që rrjedhin nga Agjenda e Reformës Evropiane për Zbatimin e MSA; si dhe ofron një numër rekomandimesh të përpiluara specifikisht për palët e interesit.

## II. Korniza Ligjore

Kontrolli i Ndhmës Shtetërore qeveriset nga Ligji për Ndhmë Shtetërore i cili thekson shprehjet, procedurat, kushtet, dhe mes tjerash, edhe procedurat e heqjes së ndihmës shtetërore të dhënë. Ndhma shtetërore mund të marrë forma të ndryshme, përfshirë burimet shtetërore, subvencionet, kreditë me shkallë interesi të preferuar, tjetërsimi i tokave apo ndërtesave me një vlerë më të ulët se ajo e tregut, dhe mes tjerash, shlyerjet e borxheve – të gjitha këto mund të sjellin avantazh ndaj përfituesve për shkak të trajtimit selektiv dhe preferencial.<sup>9</sup> Përveç specifikimit të detyrave dhe përgjegjësive të Departamentit për Ndhmë Shtetërore si organi kryesor administrativ përgjegjës për kontrollin e ndihmës shtetërore, si dhe të Komisionit që përfaqëson organin vendim-marrës, Ligji poashtu specifikon llojet e ndihmës së ndaluar të cilat mund të kenë tendencën që të shtrembërojnë konkurrencën, si dhe llojet e atyre jo të ndaluara që u

---

<sup>5</sup> Ndryshe nga ajo që ka ndodhur me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova e ka nënshkruar MSA-në me BE-në si një subjekt i vetëm, çka u bë e mundur vetëm pas Traktatit të Lisbonës. Ky lloj i dha BE-së një personalitet ligjorë, duke i transferuar kështu Komisionit më shumë kompetenca – Përfshirë poashtu nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës kjo ka qenë me përfitim kur marrim parasysh çështjen e mos-njohjes së pavarësisë së saj nga 5 vende anëtarë të BE-së.

<sup>6</sup> Erez Pula (2019), “(Un) leveling the field – A Competition Tale (II)”, Grupi Për Studime Ligjore dhe Politike, Prishtinë, në dispozicion në: <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2019/03/Unlevelling-the-competition-field-Eng.pdf>

<sup>7</sup> Komisioni Evropian, Kontrolli i Ndhmës Shtetërore, vlerësuar me: 15 Jul 2019], në dispozicion në: [http://ec.europa.eu/competition/state\\_aid/overvieë/index\\_en.html](http://ec.europa.eu/competition/state_aid/overvieë/index_en.html)

<sup>8</sup> Dušan V. Popović (2018), “Projektimi Institucional i Autoriteteve të Ndhmës Shtetërore në Evropën Jug-lindore: Transplantimi jo i përshtatshëm Ligjor dhe Degëzimet e tij”, Autoritetet e Ndhmës Shtetërore në Evropën Jug-lindore, në dispozicion në: [https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-319-76644-7\\_4](https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-319-76644-7_4)

<sup>9</sup> Komisioni Evropian, Kontrolli i konkurrencës, Ndhmës Shtetërore’, në dispozicion në: [http://ec.europa.eu/competition/state\\_aid/overviww/index\\_en.html](http://ec.europa.eu/competition/state_aid/overviww/index_en.html)

miratohen ndërmarrësive apo disa përfituesve nga Departamenti për Ndhimë Shtetërore. Kështu që, duke pasur parasysh ndikimin që ndihma shtetërore mund të ketë në konkurrencën e drejtë, Ligji ndalon çdo lloj ndihme shtetërore që jepet nga ofruesit e ndihmës – autoritetet publike kombëtare, përveç nëse karakterizohet si një ndihmë shtetërore në përputhshmëri me ligjin.<sup>10</sup> Kjo e fundit e cila mund të jepet pa miratim paraprak të Komisionit përfshin: ndihmën e karakterit shoqëror/social, e dhënë konsumatorëve individualë, përderisa ndihma e tillë ofrohet pa diskriminim në lidhje me origjinën e produktit në fjalë; dhe ndihma me qëllim të riparimit të dëmeve të shkaktuara nga katastrofat natyrore apo ngjarjeve emergjente'.<sup>11</sup> Në mënyrë që të lehtësohet funksionalizimi i Departamentit të Ndhimës Shtetërore, ky i fundit ka hartuar Udhëzuesin e Ndhimës Shtetërore i cili ofron shpjegime të detajuara për ndihmën shtetërore, llojet e ndihmës shtetërore të cilat nuk përbëjnë vetëm grantet/subvencionet por poashtu edhe forma tjera avantazhi, dhe në mesin e tjerave, procedurat që duhet të ndiqen për njoftimin e ndihmës shtetërore.<sup>12</sup> Kjo e fundit, procedura e njoftimit, rregullohet më tej me Rregulloren për Procedurat dhe Format e Njoftimit të Ndhimës Shtetërore, e cila ka qenë një prioritet i përfshirë në Agjendën për Reforma Evropiane dhe në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA për vitin 2018. Dispozitat e kësaj rregulloreje duhet të respektohen nga të gjithë ofruesit e ndihmës shtetërore dhe përfituesit, palët relevante të interesit dhe akterë tjerë që kontrollojnë dhënien e ndihmës shtetërore.<sup>13</sup> Institucionet para dhënies së çfarëdo lloj forme të ndihmës shtetërore, duhet të njoftojnë Departamentin për Ndhimë Shtetërore duke plotësuar 'Formularin e Përgjithshëm për Njoftim të Ndhimës Shtetërore' bazuar në të cilin Departamenti për Ndhimë Shtetërore vlerëson përputhshmërinë dhe llojin e ndihmës shtetërore bazuar në dispozitat ligjore. Pas një vlerësimi të hollësishëm, Departamenti përcakton nëse njoftimi për ndihmë shtetërore përfaqëson njërën nga format e ndihmës shtetërore, dhe ky vlerësim i dërgohet Komisionit i cili merr vendimin nëse ndihma që jepet është në përputhje apo në mospërputhje me dispozitat e Ligjit. Komisioni pastaj autorizon miratimin me kushte ose pa kushte në qoftë se kemi të bëjmë me ndihmën e cila lejohet me Ligj, ndërsa në të kundërtën nëse ka dyshime që ndihma nuk është në përputhje me Ligjin, atëherë Komisioni do të iniciojë procedura formale hetimore.<sup>14</sup>

Edhe pse Rregullorja për Procedurat dhe Format e Njoftimit të Ndhimës Shtetërore detajon procesin e njoftimit të ndihmës shtetërore, ky mekanizëm nuk është funksionalizuar apo përdorur ende nga institucionet dhe ofruesit e ndihmës shtetërore.

---

<sup>10</sup> Ligji për Ndhimë Shtetërore Nr. 05/L-100, Neni 3, 4 në dispozicion në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/AB373100-5DE7-45A4-BE96-CD1EF11E79AE.pdf>

<sup>11</sup> Ligji për Ndhimë Shtetërore Nr. 05/L-100, Article 3, 4, available at:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/AB373100-5DE7-45A4-BE96-CD1EF11E79AE.pdf>

<sup>12</sup> Departamenti për Ndhimë Shtetërore (2019), *Udhëzuesi i Ndhimës Shtetërore*, Ministria e Financave, në dispozicion në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/B7F80FAF-32A8-4DC0-BB5A-C959B70F4759.pdf>

<sup>13</sup> Rregullorja (QeK) Nr.19/2018 Për Procedurat dhe Format e Njoftimit të Ndhimës Shtetërore, në dispozicion në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/C6423C79-3933-4F7F-BOA3-AEFE0B44DOA3.pdf>

<sup>14</sup> Rregullorja (QeK) Nr.19/2018 Për Procedurat dhe Format e Njoftimit të Ndhimës Shtetërore, në dispozicion në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/C6423C79-3933-4F7F-BOA3-AEFE0B44DOA3.pdf>

Siç u elaborua më sipër, racionalja për futjen e dispozitave kombëtare që rregullojnë kontrollin e ndihmës shtetërore i atribuohet procesit të Integritimit Evropian, specifikisht zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Është e tepërt të përsëritet që përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit kombëtar, me atë të BE-së, përfaqëson thelbin kryesor të MSA-së. Thënë këtë, neni 75 i MSA-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së thekson ndalimin e çdo ndihme shtetërore 'e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrësi të caktuara ose produkte të caktuara'. Ky përkufizim buron drejtpërdrejt nga neni 107 (1) i Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).<sup>15</sup> MSA e mbështet më tej këtë propozim duke deklaruar se Palët (BE dhe Kosova) janë pajtuar që 'gjatë pesë viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë shtetërore e dhënë nga Kosova do të vlerësohet duke marrë parasysh faktin se Kosova vlerësohet si një zonë identike me ato zona të BE-së të përshkruara në nenin 107 (3) (a) të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian'.<sup>16</sup>

Komisioni Evropian, për të lehtësuar procedurat e vështira për marrjen e njoftimit paraprak dhe miratimin për ndihmën shtetërore nga Komisioni, ka miratuar të ashtuquajturin Rregullorja e Përgjithshme për Përrjashtim në Bllok - RrPPB për ndihmën shtetërore, a cila specifikon kategoritë e Ndihmës Shtetërore dhe disa kushte në përputhje me Traktatin. RrPPB jo vetëm që thjeshton procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, por gjithashtu kontribuon në alikoimin e parasë publike drejt qëllimeve të interesit të përbashkët, siç janë promovimi i inovacionit dhe kërkimit, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi rajonal, punësimi dhe sipërmarrja, si dhe nismat themelore të investimeve.<sup>17</sup>

Për më tepër, Rregullorja de minimis - ose Rregullorja për Ndihmën Minimale- është miratuar posaçërisht për ofrimin e ndihmës së vogël që nuk i nënshtrohet mekanizmave të kontrollit të ndihmës shtetërore, meqenëse nuk shtrembëron tregtinë dhe konkurrencën në tregun e brendshëm. Për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore kjo ndihmë nuk ka nevojë për njoftim dhe aprovim paraprak nga Komisioni, duke ulur kështu edhe barrën administrative për shtetet anëtare të BE-së dhe kompanitë. Kriteret kryesore të kësaj rregulloreje janë 'ruajtja e tavanit prej 200 000 EUR si shumë e ndihmës 'de minimis' që një ndërmarrje e vetme mund të marrë për secilin Shtet Anëtar për çdo periudhë tre vjeçare', përderisa nuk e shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën e tregut.<sup>18</sup>

---

<sup>15</sup> Versionet e konsoliduara të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian 2012/C 326/01, në dispozicion në: [https://eur-lex.europa.eu/eli/treaty/tfeu\\_2012/oj](https://eur-lex.europa.eu/eli/treaty/tfeu_2012/oj)

<sup>16</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian (2015), "Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike nga njëra anë, dhe Kosova\*, nga ana tjetër", në dispozicion në: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation\\_and\\_association\\_agreement\\_eng\\_0.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf)

<sup>17</sup> Komisioni Evropian, Konkurrenca – Legjislacioni për Ndihmë Shtetërore, – Rregulloret e përjashtimit në Bllok, në dispozicion në: [http://ec.europa.eu/competition/state\\_aid/legislation/block.html](http://ec.europa.eu/competition/state_aid/legislation/block.html)

Komisioni Evropian, (2016), "EU Competition Policy in Action: Comp in Action", në dispozicion në: <http://ec.europa.eu/competition/publications/kd0216250enn.pdf>

<sup>18</sup> Rregullore e Komisionit (EU) No 1407/2013 e datës 18 dhjetor 2013 për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën 'de minimis' në dispozicion në: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L\\_.2013.352.01.0001.01.ENG](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2013.352.01.0001.01.ENG)



Përveç MSA-së dhe acquis-së së BE-së, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore - CEFTA gjithashtu thekson ndalimin e dhënies së ndihmës shtetërore. Më saktësisht - "çdo ndihmë e dhënë nga një Palë ose përmes burimeve shtetërore në çfarëdo forme të mundshme që shtrembëron ose kërcënon për të shtrembëruar konkurrencën duke favorizuar disa mallra, për aq sa mund të ndikojë në tregtinë midis Palës në fjalë dhe Palëve të tjera të kësaj Marrëveshjeje [përfshirë Kosovën], do të jetë e papajtueshme me funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje".<sup>19</sup>

Duke u bazuar në të gjitha këto, korniza legjislative e tanishme, konkretisht Ligji për Ndhimën Shtetërore, është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e (BE) 2015/1589 e cila parashikon rregulla të detajuara për zbatimin e nenit 108 të TFBE – Ndhimat e dhëna nga Shtetet. Sidoqoftë, një ekzaminim i plotë i kornizës ligjore të Kosovës sugjeron që përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me atë të BE-së është më se i nevojshëm, veçanërisht legjislacioni dytësor përfshirë Rregulloren 'De Minimis', Rregulloren për Ndhimën Rajonale, si dhe Rregulloren për Ndhimën Horizontale të Shtetit, siç edhe parashihet nga PKZMSA 2019 - 2023.<sup>20</sup>

### III. Departamenti për Ndhimë Shtetërore dhe Komisioni

Në fillim, zyra administrative për kontrollin e ndihmës shtetërore, përkatësisht Zyra për Ndhimë Shtetërore, është themeluar në kuadër të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Ndërsa Ligji i ri për Ndhimë Shtetërore, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2017, specifikon se Departamenti i Ndhimës Shtetërore duhet të transferohet në kuadër të Ministrisë së Financave.<sup>21</sup> Në vijim të transferimit të tij, departamenti për Ndhimë Shtetërore ka vazhduar të ndërmarrë hapat e nevojshëm për funksionimin e tij të përditshëm, përfshirë edhe punësimin e 7 nëpunësve. Megjithatë koncepti i Ndhimës Shtetërore është relativisht koncept i ri, Departamenti ka hartuar një plan të detajuar pune që duhet të ndiqet nga nëpunësit e tij, në mënyrë që të lehtësojë periudhën e tij tranzitore.

Aktualisht, Departamenti po bën përpjekje të mëdha për të arritur në mënyrë simultane tre objektivat kryesore, hartimin e legjislacionit dytësor i cili mbulon fushën e ndihmës shtetërore; avancimin e kapaciteteve të departamentit; dhe përmbylljen e masave që rrjedhin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim. Për sa i përket avancimit të mëtejshëm të kapaciteteve, Departamenti ka marrë ndihmë teknike nga një projekt i mbështetur nga Ambasada Britaneze, një projekt binjakëzimi ndërmjet Kosovës dhe BE-së, dhe një projekt projekti i mbështetur nga IPA II në emër të KE.<sup>22</sup>

Nga ana tjetër, Ligji për Ndhimë Shtetërore përcakton se organi vendim-marrës për Departamentin e Ndhimës Shtetërore, përkatësisht Komisioni për Ndhimë Shtetërore,

<sup>19</sup> Marrëveshja për Ndryshimin e Pranimit dhe Hyrjen në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (2006), në dispozicion në: [http://www.mvteo.gov.ba/data/Home/Dokumenti/ANNEX\\_1CEFTA\\_2006ENG.pdf](http://www.mvteo.gov.ba/data/Home/Dokumenti/ANNEX_1CEFTA_2006ENG.pdf)

<sup>20</sup> Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (PKZMSA) 2019-2023

<sup>21</sup> Ligji për Ndhimën Shtetërore nr. 05/L-100, neni 23 Dispozitat Kalimtare, në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/AB373100-5DE7-45A4-BE96-CD1EF11E79AE.pdf>

<sup>22</sup> Intervistë personale me drejtorin e Departamentit për Ndhimë Shtetërore, Mr. Agim Krasniqi, 22 korrik 2019

duhet të përbëhet nga pesë anëtarë me ekspertizë në këtë fushë. Anëtarët e Komisionit janë caktuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për një mandat prej tre vitesh, me mundësinë që të zgjidhen edhe për një mandat të dytë shtesë. Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, anëtarët e Komisionit nuk duhet të mbajnë një pozitë të caktuar ose funksion publik të emëruara politikisht. Anëtarët e Komisionit për Ndhimë Shtetërore janë përgjegjës që të miratojnë rregullat dhe procedurat, si dhe masat e nevojshme kundër konfliktit të interesit.<sup>23</sup>

Emërimi i anëtarëve të Komisionit për Ndhimë Shtetërore poashtu ka qënë një ndër masat e parapara nga Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA).<sup>24</sup> Në këtë mënyrë, në Korrik 2018 Kuvendi inicioi procedurat e emërimit të anëtarëve të Komisionit, ndërkohë që në Mars të vitit pasardhës u përzgjedhën pesë anëtarët e Komisionit për Ndhimë Shtetërore.<sup>25</sup> Ndërkohë, Raporti i KE-së për Kosovën i vitit 2019 e cilësoi si thelbësor operacionalizimin e Komisionit për Ndhimë Shtetërore duke pasur parasysh që rekomandimet që rrjedhin nga Raporti i mëparshëm për Vendin mbeten ende të pa-adresuara, duke pamundësuar kështu njoftimet ex-ante dhe kontrollimet ex-post të ndihmës shtetërore.<sup>26</sup>

#### IV. Masat e Ndhimës Shtetërore të përfshira në ARE dhe PKZMSA për 2018 – 2019

Në mesin e prioriteteve kryesore të Departamentit të Ndhimës Shtetërore është poashtu edhe përbushja e masave që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim. Duke qënë në mesin e marrëveshjeve më të rëndësishme për Kosovën, zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asociimit udhëzohet nga dy korniza kryesore – PKZMSA dhe ARE - të hartuara posaçërisht për të përshpejtuar implementimin e marrëveshjes. Që të dy dokumentet përfshijnë masa dhe prioritete që duhet të zbatohen në fusha të ndryshme, përfshirë gjithashtu edhe fushën e Ndhimës Shtetërore.

ARE – Progresi gjatë vitit 2018<sup>27</sup>: Sipas Agjendës për Reforma Evropiane, institucionet relevante – Ministria e Financave dhe Kuvendi i Kosovës – ishin përgjegjëse për përbushjen e tre masave gjatë vitit 2018, specifikisht:

- Miratimin i legjislacionit dytësor për Ndhimën Shtetërore,

<sup>23</sup> Ligji për ndihmë shtetërore nr. 05/L-100, Neni 9 Komisioni I Ndhimës Shtetërore, në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/AB373100-5DE7-45A4-BE96-CD1EF11E79AE.pdf>

<sup>24</sup> Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (PKZMSA) 2019-2022; Agjenda e Reformës Evropiane (ARE) (2016), Kosova – Dialog I Nivelit të Lartë të BE-së për Prioritetet kyçe

<sup>25</sup> Arbisa Shefkiu (2019), "Kuvendi komplet Komisionin për Ndhimë Shtetërore sipas rekomandimeve të britanikeve", Kallxo.com, [accessed on: 10 July], në dispozicion: <https://kallxo.com/kuvendi-komplet-komisionin-per-ndihme-shtetere-sipas-rekomandimeve-te-britanikeve/>

<sup>26</sup> Komisioni Evropian (2019), "Raporti i Kosovës 2019 që shoqëron dokumentin Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve 2019, Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE", Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, Bruksel, në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

<sup>27</sup> Agjenda e Reformës Evropiane (ERA) (2016), Kosovë - Dialog i nivelit të lartë të BE për përparësitë kryesore

- Funkcionalizimin e Departamentit për Ndhimë Shtetërore, dhe
- Operacionalizimin e Komisionit për Ndhimë Shtetërore.

Përveç funksionalizimit të Departamentit për Ndhimë Shtetërore, dy masat e tjera janë përmbushur vetëm pjesërisht gjatë vitit 2018. Në këtë aspekt, Komisioni i Ndhimës Shtetërore u funksionalizua gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, ndërsa miratimi i legjislacionit dytësor ka qenë ende në progres edhe në fund të vitit 2018, me përjashtim të Rregullores për Procedura të Njoftimit të Ndhimës Shtetërore, e cila u miratua në tremujorit e fundit të 2018.

PKZMSA - Progresi gjatë vitit 2018 dhe 2019<sup>28</sup>: Në mënyrë të ngjashme, tabela 1 shfaq të gjitha masat e PKZMSA-së të cilat janë paraparë të zbatohen nga institucionet relevante gjatë vitit 2018 dhe pjesës së parë të 2019 (Janar- Qershor). Gjatë vitit 2018, Ministria e Financave është dashur të përmbushë vetëm dy masa, të cilat ishin të përfshira poashtu edhe në Agjendën për Reforma Evropiane, përkatësisht Rregullorja për Procedura të Njoftimit të Ndhimës Shtetërore dhe funksionalizimi i Departamentit për Ndhimë Shtetërore, të cilat u përmbushën gjatë vitit 2018<sup>29</sup>.

Ndërsa, sa i përket pjesës së parë të vitit 2019, vetëm dy masa kanë qenë të parashikuara për t'u zbatuar nga Ministria e Financave në fushën e kontrollit të ndihmës shtetërore, specifikisht:

- Miratimi i Rregullores të Ndhimës Shtetërore *De Minimis'*, e cila sipas Departamentit për Ndhimë Shtetërore është hartuar dhe dërguar për miratim, dhe
- Hartimi i udhëzimeve për krijimin e Inventarit të Ndhimës Shtetërore, i cili është finalizuar me ndihmën dhe ekspertizën e ofruar nga Ambasada e MB-së.<sup>30</sup>

Ndërsa, siç paraqitet në tabelë, për pjesën e dytë të vitit 2019, PKZMSA parasheh shtatë (7) masa për t'u përmbushur nga Ministria e Financave, përkatësisht aktet nën-ligjore, të cilat janë thelbësorë drejt mirë-funksionimit të Departamentit për Ndhimë Shtetërore dhe të Komisionit. Masat e parapara për pjesën e dytë të vitit 2019 përfshijnë Rregulloren Regjionale për Ndhimë Shtetërore, Rregulloren për Ndhimë Shtetërore Horizontale, masa specifike për të ngritur vetëdijësimin e ofruesëve të ndihmës shtetërore, dhe krijimin e Inventarit të Ndhimës Shtetërore.<sup>31</sup> Duhet të theksohet se inventari fillestar është hartuar tashmë dhe duhet të përditësohet në baza të rregullta. Sipas përfaqësuesve të DNSh, inventari fillestar është ndarë poashtu edhe me zyrën e BE-së në Kosovë.<sup>32</sup>

**Tabela 1:** Prioritetet e Ndhimës Shtetërore, ARE 2018 dhe PKZMSA 2018 - 2019

<sup>28</sup>Kjo pjesë përmban të dhëna vetëm për pjesën e parë të vitit 2019, konkretisht nga janari deri në fund të qershorit.

<sup>29</sup> Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2018-2022

<sup>30</sup> Intervistë personale me Drejtorin e Departamentit për Ndhimë Shtetërore, Mr. Agim Krasniqi, 22 korrik 2019

<sup>31</sup> Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (PKZMSA) 2019-2023

<sup>32</sup> Intervistë personale me drejtorin e Departamentit për Ndhimë Shtetërore, Mr. Agim Krasniqi, 22 korrik 2019

| <b>Nr.</b> | <b>Objektivat/Ref. Korniza</b> | <b>Aktet ligjore vendore për t'u përafuar</b>  | <b>Aktet nga Acquis e BE-së për t'u transferuar</b>  | <b>Institucionet përgjegjëse</b> |
|------------|--------------------------------|--|--|----------------------------------|
| <b>1.</b>  | Neni 75, paragrafët 1a dhe 1b  | Rregullorja për Procedurat e Njoftimit të Ndhmës Shtetërore (plotësuar-ndryshuar) e miratuar | Rregullore e Komisionit (KE) Nr. 794/2004 e datës 21 Prill 2004 për zbatimin e Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 659/1999. Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 271/2008 e 30 Janarit 2008 që plotëson rregulloren e KE Nr. 794/2004 | MF<br><b>T2 2018</b>             |
| <b>2.</b>  | Neni 74 dhe 75                 | Funksionalizimi I Departamentit  | Pesë (5) zyrtarë të rekrutuar  | MF<br><b>T2 2018</b>             |
| <b>3.</b>  | Neni 75, paragrafët 1a dhe 1b  | Rregullorja për Ndhmën Shtetërore De Minimis Rregullore e re), e miratuar                    | Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1407/2013 për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën De Minimis (18/12 / 2013-2020)  | MF<br><b>T2 2019</b>             |
| <b>4.</b>  | Neni 74 dhe 75                 | Fillimi i Udhëzimeve për krijimin e Inventarit të Ndhmës Shtetërore                          | Udhëzime për krijimin e një Inventari të Ndhmës Shtetërore, të hartuar   | MF<br><b>T2 2019</b>             |
| <b>5.</b>  | Neni 75, paragrafët 1a dhe 1b  | Rregullore për Ndhmën Rajonale, e miratuar   | Nenet 101 deri 109 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU)   | MF<br><b>T4 2019</b>             |
| <b>6.</b>  | Neni 75, paragrafët 1a dhe 1b  | Rregullore për Ndhmën Shtetërore horizontale, e miratuar                                     | Rregullorja e Këshillit Nr. 2018/1911 e datës 26 nëntor 2018 për ndryshimin e Rregullores (BE) 2015/1588 të 13 korrikut 2015 për zbatimin e neneve   | MF<br><b>T4 2019</b>             |
| <b>7.</b>  | Neni 74 dhe 75                 | Ndërgjegjësimi mbi Rregullat e Ndhmës Shtetërore për ofruesit dhe avokatin                   | Sesione informimi (seanca trajnimi, punëtori me ofruesit e ndihmës shtetërore)   | MF<br><b>T4 2019</b>             |
| <b>8.</b>  | Neni 74 dhe 75                 | Ndërgjegjësimi mbi Rregullat e Ndhmës Shtetërore për ofruesit dhe avokatinë                  | Plotësimi i formularëve të njoftimit nga institucioni i dhënies së ndihmës shtetërore  | MF<br><b>T4 2019</b>             |
| <b>9.</b>  | Neni 74 dhe 75                 | Ndërgjegjësimi mbi Rregullat e Ndhmës Shtetërore për ofruesit dhe avokatinë                  | Në trajnimin e punës për të paktën shtatë (7) zyrtarë  | MF<br><b>T4 2019</b>             |
| <b>10.</b> | Neni 74 dhe 75                 | Ndërgjegjësimi mbi Rregullat e Ndhmës Shtetërore për ofruesit dhe avokatinë                  | Janë mbajtur të paktën dy (2) punëtori për institucionet e dhënies së ndihmës shtetërore   | MF<br><b>T4 2019</b>             |

|     |                |   |   |               |
|-----|----------------|---|---|---------------|
| 11. | Neni 74 dhe 75 | Krijimi i një Inventari Ekzistues për Ndhmën Shtetërore | Inventarizimi i Ndhmës Shtetërore, i përfunduar | MF<br>Q4 2019 |
|-----|----------------|---|---|---------------|

\*për vitin 2019, tabela portretizon informacionin vetëm për periudhën Janar – Qershor.

## V. Ndhma Shtetërore: Instrument investues apo shtrembërues i konkurrencës?

Kontrolli i Ndhmës Shtetërore ka ndryshuar në mënyrë substanciale gjatë dekadës së fundit, si nevoj për të modernizuar rregulloret ekzistuese për shkak të sfidave politike dhe ekonomike të identifikuar në strategjinë e rritjes së Evropës 2020. Nga viti 2012, Komisioni Evropian publikoi një komunikim lidhur me Modernizimin e Ndhmës Shtetërore të BE-së (MNSh) i cili kishte synim një ekonomi të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse përmes krijimit të vendeve të punës, produktivitetit dhe përfshirjes shoqërore. Për të arritur këtë, Komisioni Evropian u përqendrua në dy elemente, në tregun e integruar pa kufij kombëtar, dhe politikën e konkurrencës dhe kontrollin e ndhmës shtetërore me qëllim që të sigurohet një konkurrencë e mirëfilltë në treg. Duke iu referuar kësaj të fundit, thelbi i këtij komunikimi thekson nevojën për të promovuar një përdorim më të mirë të burimeve publike të kanalizuar drejt rritjes dhe kufizimit të shtrembërimeve të konkurrencës që mos të dëmtohet tregu i brendshëm'.<sup>33</sup>

Përveç Rregullores de minimis dhe Rregullores së përgjithshme të Përjashtimit në Bllok, Komisioni Evropian ishte i vendosur për të modernizuar më tutje kornizën ligjore ekzistuese me qëllim që të arrihet një rritje më e shpejtë dhe konkurruese në tregun e brendshëm, si dhe të mundësojë shqyrtimin dhe dhënien më të shpejtë të vendimeve.<sup>34</sup> Të gjitha këto iniciativa kanë treguar që Ndhma Shtetërore mund të promovojë investimin, por vetëm nëse rregullohet dhe kontrollohet siç duhet. Ko është dëshmuar nga shumë raste në shtetet anëtare të BE-së ku politika e ndhmës shtetërore ka kanalizuar investime të mëtejshme dhe rritje ekonomike.

Francë: Ndërtimi i një terminali të ri – Në 2015, Komisioni Evropian vendosi që 270 milionë € të dedikuara për një projekt për të ndërtuar një terminal të ri në portin e Calais nuk e shtrembëron konkurrencën dhe është në përputhje me rregullat për ndhmë shtetërore të BE-së. Komisioni e bazoi vendimin e tij në analiza të detajuara financiare të paraqitura nga Franca, të cilat sugjerorin që të hyrat e terminalit janë të pamjaftueshme vetëm për të mbuluar shpenzimet e investimit për 50 vitet e ardhshme. Komisioni poashtu

<sup>33</sup> Komisioni Evropian (2012), Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Modernizimi i Ndhmës Shtetërore të BE (MNSh), në dispozicion në:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52012DC0209&from=EN>

<sup>34</sup> Komisioni Evropian (2016), 'Politika e konkurrencës së BE-së në Veprim', në dispozicion në:

<http://ec.europa.eu/competition/publications/kd0216250enn.pdf>

doli në përfundim se efektet pozitive nga ky projekt do të tejkalonin ato negative që kjo ndihmë shtetërore mund të ketë në konkurrencë.<sup>35</sup>

Gjermania: Ndërtimi i 20 turbinave/mullinjëve të erës në det të hapur – Nga fundi i 2014, Gjermania njoftoi Komisionin Evropian në lidhje me qëllimin për të mbështetur ndërtimin e 20 turbinave/mullinjëve të erës në det të hapur, në Detin e Veriut dhe Detin Balltik. Kjo mbështetje, në formën e ndihmës shtetërore, do t'u dhurohej operatorëve si një 'premium' i paguar ekstra përveç çmimit të energjisë në treg. Komisioni miratoi këtë kërkesë duke dalë në përfundim se projekti do të ndihmojë Gjermaninë që të arrijë synimet e vitit 2020 për energji të pastër; projekti nuk e shtrembëron konkurrencën e tregut marrë parasysh që ndihma e dhënë është e mjaftueshme vetëm për të realizuar këtë investim specifik; dhe në të ardhmen, ky projekt do të jetë me përfitim për konkurrencën për faktin se ofruesit e energjisë do të jenë në gjendje ti qasen tregut Gjerman të prodhimit të energjisë.<sup>36</sup>

Një tjetër rast i ngjashëm ka të bëjë me miratimin e ndihmës shtetërore për të mbështetur ndërtimin e një turbine/mulli me erë në det të hapur në ujërat e Francës. Pas vlerësimit të mbështetjes sipas rregullave të BE-së për Ndihmë Shtetërore, Komisioni Evropian vendosi në favor, bazuar në argumentin se ndihma do të shpie në uljen e emetimit të CO<sub>2</sub>, dhe më e rëndësishmja nuk do të shtrembërojë konkurrencën në tregun e përbashkët.<sup>37</sup>

Italia: Shpërndarja e gazetave me tarifa të reduktuara - Italia ia besoi 'Poste Italiane' shpërndarjen e gazetave dhe botimeve të botuesve të librave dhe organizatave jo-fitimprurëse për periudhën 2017-2019, me tarifa të reduktuara. Ky shërbim bie nën interesin e përgjithshëm ekonomik - SHPE - i cili synon të ruajë dhe nxisë pluralitetin dhe diversitetin e mediave përmes shpërndarjes së disa kategorive të shtypit me norma të reduktuara. Duke marrë parasysh këtë, Komisioni Evropian vlerësoi kërkesën e Italisë dhe miratoi ndihmën prej 171,74 milion € për të kompensuar 'Poste Italiane' në mënyrë që të mbulojë koston neto të ngarkuar për ofrimin e këtij shërbimi. Bazuar në rregullat e ndihmës shtetërore të BE për kompensimin e shërbimit publik, Komisioni zbuloi se kjo shumë e ndihmës shtetërore nuk tejkalon shumën e nevojshme për të kompensuar koston neto të ngarkuar nga 'Poste Italiane'.<sup>38</sup>

Siç u elaborua përmes këtij studimi, ndihma shtetërore e pakontrolluar, e dhënë ndërmarrësive dhe bizneseve mund të ketë ndikime negative në konkurrencë duke ofruar trajtime preferenciale disa kompanive, dhe njëkohësisht duke ua imponuar barrën

---

<sup>35</sup> Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp (2015), Ndihma shtetërore: Komisioni aprovon 270 milion € në ndihmë investimi për zgjerimin e Portit të Calais, në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-5301\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-5301_en.htm)

<sup>36</sup> Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp (2015), Ndihma shtetërore: Komisioni miraton mbështetjen për 20 fermat në det të hapur në Gjermani, në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_MEX-15-4789\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_MEX-15-4789_en.htm)

<sup>37</sup> Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp (2019), Ndihma shtetërore: Komisioni miraton mbështetjen për gjashtë ferma në det të hapur në Francë, në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-19-4749\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-19-4749_en.htm)

<sup>38</sup> Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp (2019), Ndihma shtetërore: Komisioni aprovon dëmshpërblim prej 171,7 milion € Poste Italiane për shpërndarjen e fotove me tarifa të reduktuara, në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-19-4473\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-19-4473_en.htm)

financiare të tjerëve si dhe taksa-paguesve. Rastet e tilla ndalohen në mënyrë strikte sipas rregullave të ndihmës shtetërore të BE-së, siç është vërtetuar edhe me rastet në vijim.

Gjibraltari: avantazhe taksash të paligjshme për kompanitë shumëkombëshe - Komisioni Evropian kreu një hetim të plotë mbi përfitimet tatimore të dhëna për disa ndërmarrje internacionale nga Gjibraltari. Kjo e fundit përmes një skeme të përjashtimit nga taksat e korporatave dhe pesë aktvendimeve tatimore ka ofruar trajtim preferencial dhe përfitime selektive për një numër ndërmarrjesh internacionale. Komisioni deklaroi se një trajtim i tillë preferencial është i ndaluar sipas rregullave të ndihmës shtetërore të BE-së, dhe taksat e papaguara duhet të rikuperohen në mënyrë që të rivendoset trajtimi i barabartë midis kompanive të tjera. Sipas rregullave të BE-së, në këtë rast ndihma shtetërore duhet të rikuperohet, dhe përfituesit duhet të kthejnë taksat e papaguara në Gjibraltari në mënyrë që të riparojnë shtrembërimin e konkurrencës. Duhet të theksohet se në raste të tilla, përveç rikuperimit të taksave të papaguara, kompanitë në fjalë nuk penalizohen ose gjobiten. Vendimi i Komisionit shtyu Gjibraltarin gjithashtu që të largojë përjashtimet jo të ligjshme nga taksat, në mënyrë që të parandalohen rastet e tilla në të ardhmen.<sup>39</sup>

Mbretëria e Bashkuar: Skema e Taksave - Një rast i ngjashëm ka të bëjë me skemën e taksave në Mbretërinë e Bashkuar për të cilën Komisioni arriti në përfundim se një pjesë e saj shkel rregullat e ndihmës shtetërore. Arsyeja kryesore pas këtij vendimi qëndron në faktin se Mbretëria e Bashkuar përjashtoi grupe specifike të ndërmarrjeve internacionale nga skema e taksave, pa asnjë justifikim dhe arsyetim. Kështu, Mbretëria e Bashkuar siguroi një avantazh selektiv për disa ndërmarrje, duke shkelur parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë tatimpaguesve. Duke pasur parasysh se ngjarje të tilla janë të paligjshme sipas rregullave të ndihmës shtetërore të BE-së, Mbretëria e Bashkuar duhet të rikuperojë ndihmën e paligjshme shtetërore - përfitimet e padrejta të taksave - nga përfituesit selektiv.<sup>40</sup>

Raste të tilla të ofrimit të ndihmës shtetërore të paligjshme ndaj kompanive kanë ndodhur edhe në Kosovë, megjithatë, pa ndonjë vlerësim të duhur ose hetim të hollësishëm nga institucionet përkatëse - përkatësisht Departamenti i Ndihmës së Shtetit dhe Komisioni i tij - duke çuar në mungesë të vendimeve dhe revokimit përkatës të ndihmës shtetërore. Ky fenomen është theksuar edhe nga raporti i fundit për Vendin i KE-së në lidhje me ndihmën e dhënë për sektorë të ndryshëm, siç është edhe sektori i telekomunikacionit, pa ndjekur procedurat e parashikuara nga korniza ligjore. Një rast tjetër, për të cilin ka reaguar edhe shoqëria civile në Kosovë, që gjithashtu anashkaloi procedurat e njoftimit dhe hetimit është marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe 'ContourGlobal' për ndërtimin e termocentralit të ri 'Kosova e Re'. Kjo e fundit përmban

---

<sup>39</sup> Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp (2018), Ndihma shtetërore: Komisioni del në përfundim se Gjibraltari i dha rreth 100 milion euro avantazhe të paligjshme tatimore për kompanitë shumëkombëshe, në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-18-6889\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-18-6889_en.htm)

<sup>40</sup> Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp (2019), Ndihma Shtetërore: Komisioni del në përfundim se një pjesë e skemës së taksave në Mbretërinë e Bashkuar u dha avantazhe të paligjshme tatimore disa kompanive shumëkombëshe; pjesa e mbetur nuk përbën ndihmë, në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-19-1948\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-19-1948_en.htm)

elemente të qarta të ndihmës shtetërore që shtrembërojnë konkurrencën në tregun e energjisë.<sup>41</sup>

Korniza aktuale ligjore në Kosovë specifikon që institucionet që ofrojnë ndihmë shtetërore janë të detyruara që të paraqesin në Departamentin për Ndhimë Shtetërore të gjitha të dhënat për skemat ekzistuese, gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndhimë Shtetërore. Për më tepër, Ligji specifikon që Komisioni duhet të sigurojë dhe hetojë që të gjitha rastet e ndihmës shtetërore të dhëna janë në pajtueshmëri me rregullat e ndihmës shtetërore. Komisioni mund të ndërpresë çdo ndihmë shtetërore të dhënë dhe të fillojë procedurat hetimore nën dyshimin se ndihma e dhënë është në shkelje me dispozitat e Ligjit.<sup>42</sup> Sidoqoftë, ende nuk ka pasur ndonjë lëvizje përpara i përket iniciimit të procedurave hetimore për rastet e ndihmës shtetërore të dhënë në Kosovë, të cilat besohet që kanë elemente të cilat shkelin drejtpërdrejtë rregullat e ndihmës shtetërore, dhe shtrembërojnë konkurrencën në tregun e Kosovës.

## VI. Rruga përpara

Kontrolli i Ndhimës Shtetërore në Kosovë është ende në hapat e tij të hershëm të zhvillimit. Duke u transferuar në Ministrinë e Financave në vitin 2017, operimet e Departamentit të Ndhimës Shtetërore u penguan nga mungesa e një Komisioni funksional - anëtarët e të cilit u zgjodhën në Mars 2019. Duke pasur parasysh rëndësinë e tij në ruajtjen e konkurrencës dhe ndalimin e favorizimit të ndërmarrjeve të caktuara, kontrolli i ndihmës shtetërore mbetet një pjesë integrale e tregut që funksionon mirë dhe ka një konkurrence të ndershme. Në mënyrë që Departamenti i Ndhimës së Shtetit dhe Komisioni të jenë plotësisht funksionalë dhe të ushtrojnë mandatin e tyre, një përkushtim i jashtëzakonshëm duhet dedikuar arritjes së objektivave në vijim:

- Të harmonizohet më tej korniza ligjore për ndihmën shtetërore, me theks të veçantë në legjislacionin dytësor;
- Të bëhet identifikimi dhe finalizimi i inventarit të skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore;
- Të bëhet vlerësimi i përputhshmërisë së ndihmës së dhënë, qoftë nga institucionet qendrore apo ato lokale, përmes hetimeve të ndihmës ekzistuese në sektorë të ndryshëm;
- Sigurimi i zbatimit të Ligjit, veçanërisht revokimin e ndihmës në rastet e mosrespektimit të dispozitave të Ligjit në fuqi - Ligjit për Ndhimën Shtetërore;

---

<sup>41</sup> Koha Net (2019), "Marrëveshjet për ndërtimin e TC Kosova e Re, në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe BE-së", ne dispozicion ne: <https://ëëë.koha.net/arberi/162099/marreveshjet-per-ndertimin-e-tc-kosova-e-re-ne-kundershtim-me-ligjet-e-kosoves-dhe-be-se/>

<sup>42</sup> Ligji për ndihmë Shtetërore nr. 05/L-100, Article 3, 4, ne dispozicion ne: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/AB373100-5DE7-45A4-BE96-CD1EF11E79AE.pdf>



- Ofrimi i trajnimeve për stafin e Departamentit për Ndhmë Shtetërore dhe anëtarëve të Komisionit se si të zbatohet korniza ligjore që rregullon ndihmën shtetërore;
- Ofrimi i trajnimeve për ofruesit e ndihmës shtetërore brenda institucioneve, veçanërisht në lidhje me procedurat e njoftimit që duhet të ndiqen para dhënies së një ndihme shtetërore;
- Vendosja e bashkëpunimit dhe e koordinimit midis Departamentit të Ndhmës Shtetërore dhe ofruesve të ndihmës shtetërore siç janë ministritë përkatëse dhe institucionet;
- Ndhma shtetërore e përputhshme duhet të jetë transparente dhe të vlerësohet nga institucionet përkatëse për të parë nëse objektivat e synuara janë duke u përmbushur;
- Sigurimi i një kontrolli paraprak (ex-ante) i rasteve të ndihmës shtetërore, duke përfshirë rastet e ndihmës shtetërore në përputhje dhe rastet 'de minimis'.

*“Ky projekt është financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”*

## **Analiza e Politikave**

Analizat e Politikave janë raporte që diskutojnë politikat publike dhe që synojnë të ndikojnë në vendimmarrje, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror të qeverisjes. Qëllimi i Analizës së Politikave është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, të shqyrtoj argumentet e ndërlidhura me politikën përkatëse, dhe të analizojë zbatimin e saj. Përmes Analizës së Politikave, Grupi për Studime Juridike dhe Politike synon të stimulojë debat më të gjerë dhe gjithëpërfshirës mbi çështjen e dhënë, si dhe të ofroj zgjidhje të informuara dhe rekomandime për ndryshimin e politikave publike relevante, kryesisht drejtuar aktorëve dhe grupeve të interesit.



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES